
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data:18.07.2025

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje pelet dhe shërbim ngrohje për nevoja të S.O.U.GJ “Mbretëresha Geraldinë”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

44621220-7 Kaldaja me ngrohje qendrore

03419100-1 Produkte druri

Vlera e fondit limit: 8,776,800 (tetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të

shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për artikullin pelet. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se dokumentacioni i kërkuar më sipër është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar dhe ka kapacitetet për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për lëndën djegëse pelet. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për

paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike është një kërkesë proporcionale dhe ngushtësisht e lidhur me objektin e prokurimit pasi i jep mundësinë Organit Qendror Blerës për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoritetet Kontraktore përfituese për llogari të të cilëve Organi Qendror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 ose ekuivalente (e vlefshme).
- Certifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001 ose ekuivalente (e vlefshme).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikatat të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (një)** automjet ATP për transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi / qira ose në përdorim.

Shënim:

Për mjetin me status përdorimi qira/hua përdorje të disponohet kontrata përkatëse mes qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Për këtë mjet duhet të paraqesë librezë qarkullimi, aktin e kolaudimit, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetin që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objket prokurimi.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **të paktën 1 (një) kaldajë** me pelet të cilën duhet ta ketë në pronësi / qira, për të cilën duhet të paraqitet katalog/ fragmente të katalogut ose skedat teknike nga prodhuesi ose distributori i autorizuar ku të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST.

Për paisjen teknike në pronësi, (kaldaja) operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimit ose kontratë shitblerje noteriale, ose dokumentacione të tjera për të provuar pronësinë.

Nëse pajisja teknike është marrë me qera (kaldaja), duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit.

Kaldaja duhet të jetë e pajisur me çertifikatë konformiteti të inspektimit teknik të pajisjes nën presion e cila duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

Kërkesa për certifikatë konformiteti të inspektimit teknik të pajisjes nën presion është vendosur bazuar në ligjin Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion” dhe në VKM Nr. 730, date 16.11.2022 “Për miratimin e rregullit teknik “Për enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

7. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raportet e testimit ose fletë analizat nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë për produktin objekt prokurimi (pelet) me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Dëshmia me rezultatet e testimeve zyrtare duhet të jetë lëshuar brenda 12 muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Argumentim:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare dhe të sakta të produkteve që ata ofrojnë, për të cilat duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të procedurës objekt prokurimi.

Në specifikimet teknike të procedurës, peleti ka një sërë të dhënash teknike, të cilat duhet të ruajnë vlerat e duhura, në mënyrë që malli të kryejë funksionin më optimal për përmbushjen me sukses të kontratës. Në këto kushte, është kërkuar që malli i ofertuar t’i jetë nënshtruar një testi të specializuar mbi përmbushjen e parametrave të kërkuara për këtë lloj malli. Kjo kërkesë vlerësohet e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe në proporcion të plotë me të.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objektivi i Prokurimit:

Ky prokurim ka për qëllim sigurimin e shërbimit të ngrohjes së ambienteve të institucionit gjatë sezonit të ftohtë, përmes blerjes së lëndës djegëse (**pelet**) dhe vënies në dispozicion me **qira të kaldajave funksionale**, për një periudhë **24 mujore**. Nevoja për këtë shërbim buron nga:

- Mungesa e një sistemi të përhershëm të ngrohjes me eficiencë të lartë në ambientet e institucionit.
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme të temperaturës në hapësirat e brendshme për pacientët, personelin dhe vizitorët, në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe kërkesat ligjore.
- Sigurimi i një zgjidhjeje fleksibël dhe me efikasitet të lartë energjetik, duke përdorur kaldaja të reja ose të mirëmbajtura mirë dhe karburant ekologjik (biomasa pelet), i cili ka ndikim më të ulët në mjedis.

Shërbimi përfshin dy komponentë kryesorë:

1. **Blerja e lëndës djegëse (pelet)** për periudhën 24 mujore, në përputhje me nevojat reale sezonale të institucionit.
2. **Vënia në dispozicion (me qira) e kaldajave funksionale** të dimensionuara sipas sipërfaqeve që kërkojnë ngrohje, për një periudhë të njëjtë 24-mujore.

Operatori ekonomik i përzgjedhur duhet të garantojë:

- Dorëzim periodik të peletit sipas kërkesës së institucionit dhe në përputhje me kushtet teknike.
- Vendosje, mirëmbajtje dhe funksionim të sigurt të kaldajave përgjatë gjithë periudhës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE & SASITË JANË SI ME POSHTË:

Referuar planifikimit për objektin e prokurimit “**Sherbim ngrohje blerje pelet dhe kaldaja me qera për 24 muaj**”, bazohet në fluksin e punës dhe historikun e ndërhyrjeve, sasitë e planifikuara & specifikimet teknike janë si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia në ditë	Sasia e totale për dy vjet.
1	Qira Kaldaje qëndrore me pelet, fuqi >400 <500 kw, (për 360 ditë në dy vjet)	cope	1(një)	360 (ditë)
2	Pelet (per 360 ditë në dy vjet)	Kg	510 (Pesëqind e dhjete)	183,600 (kg)

Specifikimet teknike për kaldajën janë si më poshtë:

- Fuqia min/max e punës jo me pak se 392 - 530 kw
- Fuqia termike nominale jo me pak se 500 kw
- Fuqia termike e kthyer jo me pak se 459 kw
- tensioni i punës (elektrik) jo me pak se 380 v
- Fuqia motorrike jo me pak se 1100 W
- Rendimenti jo me pak se 87 %
- Presioni i ujit jo me pak se 1,5 - 3,8 bar
- Kapaciteti i ditor i silozit jo me pak se 1,5 m3

Specifikimet teknike për Peletin janë si më poshtë:

Parametra	Rezultati
Fuqia kalorifike	≥ 5 Kwh/kg
Gjatësia	10-20 mm
Diametër	6 $\pm$ 0.5 mm
Lagështira	3 – 6 %
Mbetja e hirit	1-1.5 %
Qëndrueshmëria / densiteti	1.3 t/m3
Paketimi	15 kg

- Analizë e nevojave të parashikuara për 24 muaj, është bazuar në sasinë mesatare të peletit të konsumuar në sezonët e kaluara të ngrohjes. Ulja e konsumit mesatar ditor të “peletit” është 510 kg, për shkak se godina e obstetrikës do kalojë në sistem chiller.

Për sa më sipër kërkohet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia/ dite	Sasia e diteve të punës për dy vjet	Çmimi për njësi (ditë) pa tvsh	Vlera totale (360 dite) pa tvsh
1	Qira Kaldaje qendrore me pelet, fuqi >400 <500 kw, (për 360 dite në dy vjet)	cope	1(nje)	360		
Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia ditore	Sasia për 360 ditë (2 vjet)	Çmimi për njësi në lekë pa tvsh	Vlera totale në lekë pa tvsh
2	Pelet (për 360 dite në dy vjet)	Kg	510	183,600		

TERMAT E REFERENCES:

Shërbimi i ngrohjes me kaldajë që përdor pelet

1. Kohëzgjatja dhe vazhdimësia e shërbimit:

Ofruesi i shërbimit duhet të garantojë ofrimin e shërbimit të ngrohjes **24 orë në ditë, 7 ditë në javë, pa ndërprerje**, gjatë gjithë periudhës nga **1 nëntori deri më 30 prill**, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor (AK).

2. Furnizimi me pelet:

Ofruesi i shërbimit është i detyruar të depozitojë sasinë e kërkuar të peletit **brenda 1 (një) dite kalendarike** nga momenti i njoftimit të bërë nga AK. Njoftimet do të bëhen në forma të përshtatshme për të siguruar efikasitetin dhe arritjen në kohë të informacionit.

3. Mirëmbajtja e kaldajës:

Gjatë gjithë periudhës së funksionimit të sistemit të ngrohjes, ofruesi i shërbimit do të kryejë **mirëmbajtje të rregullt teknike** të kaldajës, duke përfshirë shërbimet periodike të nevojshme për funksionimin optimal dhe të sigurt të saj. Mirëmbajtja përfshin:

- Pastrim të brendshëm dhe të jashtëm,
- Kontrollin e komponentëve elektrikë dhe mekanikë,
- Zëvendësimin e pjesëve të konsumueshme kur është e nevojshme,
- Regjistrimin dhe raportimin e çdo defekti apo ndërhyrjeje teknike në një regjistër teknik.

4. Kërkesa të tjera të posaçme:

- Ofruesi duhet të garantojë disponueshmëri të stafit teknik të kualifikuar për ndërhyrje në rast defektesh, brenda një afati maksimal prej 2 orësh nga njoftimi.
- Lënda djegëse (peleti) duhet të jetë me cilësi të lartë dhe të certifikuar, duke përmbushur standardet përkatëse të BE-së për pelet biomase.

5. Menaxhimi i mbetjeve dhe hirit të djegies

Ofruesi i shërbimit është përgjegjës për pastrimin dhe largimin e rregullt të të gjitha mbetjeve që gjenerohen nga përdorimi i kaldajës, përfshirë hirin dhe çdo mbetje tjetër të ngurtë apo të lëngshme që krijohet gjatë procesit të djegies së peletit.

- Heqja e hirit dhe mbetjeve duhet të kryhet në përputhje me një plan të mirëpërcaktuar frekuence, i cili garanton mbarëvajtjen e pandërprerë të funksionimit të kaldajës.
- Hiri dhe mbetjet duhet të transportohen dhe asgjësohen nga ofruesi në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve.
- Ofruesi i shërbimit duhet të mbajë regjistër të pastrimeve dhe asgjësimeve, i cili duhet t'i vihet në dispozicion Autoritetit Kontraktor kur kërkohet.
- Peleti duhet të dorëzohet në thasë plastikë të mbyllur hermetikisht, me peshë 15 kg secili.

- Çdo thes duhet të jetë i etiketuar me të dhënat e prodhuesit, përbërjen e peletit, datën e prodhimit dhe vlerat energjetike të deklaruar.
- Thasët duhet të jenë të papërshkueshëm nga lagështia, të rezistojnë ndaj transportit dhe ruajtjes, dhe të jenë të përshtatshëm për depozitim të sigurt pranë ambientit të kaldajës.
- Paletizimi i thasëve duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të lehtësojë ngarkim-shkarkimin dhe magazinimin.
- Të kryejë instalimin, testimin fillestar, dhe të sigurojë garanci për funksionim të qëndrueshëm gjatë gjithë periudhës së shërbimit.
- Të disponojë personel të kualifikuar për kontroll dhe ndërhyrje teknike në rast të defekteve ose nevojës për mirëmbajtje.
- Të raportojë çdo problem teknik dhe të ndërhyjë brenda 2 orëve nga njoftimi i AK-së.
- Ofruesi i shërbimit është i detyruar të sigurojë kaldajën pranë një shoqërie sigurimesh të licencuar, për të mbuluar rreziqet që lidhen me:
 - Dëmtime të pajisjes (zjarri, shpërthimi, dëmtim mekanik apo elektrik),
 - Rreziqe të mundshme ndaj palëve të treta (personelit, përdoruesve, ambientit), në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.
- Sigurimi duhet të jetë aktiv për gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të jetë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë përdorimin dhe sigurinë e pajisjeve me rrezik potencial (si kaldajat).
- Ofruesi duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor kopjen e policës së sigurimit brenda 5 ditëve nga data e lidhjes së kontratës dhe të përditësojë atë në rast ndryshimi.

GRAFIKU I LËVRIMIT:

Afatet e ekzekutimit: Afati i ekzekutimit të kësaj Marrëveshje Kuadër me afat 24 muaj do të behet sipas grafikut të shërbimi çdo ditë dhe sipas kërkesave të AK gjatë gjithë periudhës së 1 janar – 30 prill dhe 1 nëntor – 31 dhjetor të çdo viti.

Furnizimi çdo ditë do të behet për mungese të ambienteve për magazinimin e mallit (lendes djegëse pelet) dhe ruajtjes së kushteve teknike të tij. Kjo sasi furnizimi do të jete në bazë të konsumit ditor (24 orë) nga 490 kg - 510 kg/ ditë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor I cili do njoftojë me anë të e-mailit ose telefonit 1 ditë para operatorin ekonomik. Furnizimi do të kryhet nga ora 08:00 – 16:00 (orari zyrtar)

Destinacioni: Furnizimi me pelet dhe shërbimi i qerasë do të kryhet pranë ambienteve të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT